



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**MENDIMI JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT NË CILËSINË E MIKUT TË
GJYKATËS (AMICUS CURIAE)**

drejtuar

Gjykatës së Apelit

Gjykatës Themelore në Prishtinë

Gjykatës Themelore në Pejë

Gjykatës Themelore në Mitrovicë

Ex-officio nr.148/2020

në lidhje me identitetin ligjor për personat e paregjistruar

Prishtinë, më 11 gusht 2020

Qëllimi

1. Ky Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), në proceset gjyqësore lidhur me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe të mbrojtjes nga diskriminimit, ka të bëjë me tërheqjen e vëmendjes së institucioneve publike/shtetërore (gjykatave) në trajtimin dhe ndërmarrjen e masave në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisve ligjore në përshpejtimin e procedimit të padive me qëllim të realizimit të së drejtës themelore njerëzore, siç është **identiteti ligjor** për personat e peregjistruar.
2. Prandaj, për këtë qëllim Avokati i Popullit, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ua paraqet këtë Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*).

Baza ligjore

3. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹ (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/ 26 qershor 2015², Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Avokatin e Popullit), pos tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

3.1. *Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);*

3.2. *Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);*

3.3. *Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit (neni 16, paragrafi 9, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*

3.4. *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).*

Faktet dhe rrethanat e rastit

4. Më 25 shkurt 2020, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka hapur hetim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) lidhur me identitetin ligjor të personave të peregjistruar.
5. Avokati i Popullit, në bazë të informatave të marra në terren dhe të ankesave të pranuar nga qytetarët, ka identifikuar disa individë pa identitet juridik, të cilët nuk mund të kenë qasje në të drejtat themelore të njeriut. Deri në publikimin e këtij Mendimi Juridik, 23 individë të moshave të ndryshme janë duke pritur zgjidhje në nivelin gjyqësor.
6. Më 4 maj 2020, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K)³ ka parashtruar kërkesë, përmes së cilës ka vënë në dijeni Institucionin e Avokatit të Popullit për zgjatjen

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

³ Ndër të tjera, CRP/K është organizatë joqeveritare vendore që merret me ofrimin e ndihmës juridike falas për kategoritë e cenuara të popullatës së Republikës së Kosovës dhe është partner i UNHCR-së në programet e ndihmës ligjore.

e procedurës në shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesëpaditë të dorëzuara në gjykatat përkatëse kompetente.

7. Ndër të tjera, CRP/K është organizatë joqeveritare vendore që merret me ofrimin e ndihmës juridike falas për kategoritë e cenuara të popullatës së Republikës së Kosovës dhe është partner i UNHCR-së në programet e ndihmës ligjore.
8. CRP/K, në ushtrimin e së drejtës për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe përfaqësimin e palëve, ka dorëzuar në gjykatat themelore dhe në Gjykatën e Apelit një numër të konsiderueshëm të kërkesëpadive të natyrës civile dhe administrative dhe që ende nuk është vendosur për këto raste sipas referencave, si në vijim:

8.1 Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë, Departamenti për Çështje Civile: C.nr-621/19;

8.2 Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Çështje Civile: C.699/19, C.nr.41/19, C.nr.121/19, C.nr.202/19, C.nr.189/16;

8.3 Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile: **C.nr.2356/2018, C.nr.2290/17, C.nr. 2692/19;**

8.4 Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë: **C.nr.98/16;**

8.5 Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti për Çështje Civile: C.nr.709/18;

8.6 Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative: **A.nr.1380/19, A.nr.2679/19;**

8.7 Gjykata e Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative: A.nr.1735/17;

8.8 Gjykata e Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm: C.nr.69/19, C.nr.92/18, C.nr.541/18.

9. Palëve në referencat e cekura më lart u është prolonguar ushtrimi i të drejtave elementare, siç janë: regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale civile (certifikata të gjendjes civile dhe letërnjoftime etj.) të Republikës së Kosovës, të garantuara me akte juridike nacionale (*Ligji nr.04/L-003 për Gjendjen Civile; Ligji nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës; Ligji nr.05/L-015 për Letërnjoftim; Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës etj.*) dhe instrumentet ndërkombëtare për liritë dhe për të drejtat e njeriut, të cilat gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës. Kjo gjendje këta persona i bënë juridikisht "*të padukshëm*" dhe ua mohon gëzimin e të drejtave ekonomike, politike, kulturore dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut.
10. Shumica prej personave të identifikuar u përkasin grupeve të cenuara etnike që jetojnë në territorin e Republikës së Kosovës, që nga koha e lindjes, pa dokumente personale nga gjendja civile, përkatësisht regjistrimi civil apo letërnjoftim. Pra, këta individë po përballen me vështirësi në nivelin administrativ në instancë të parë e të dytë, si dhe në atë gjyqësor për realizimin e së drejtës themelore të tyre, regjistrimin e lindjes dhe të shtetësisë.

Instrumentet relevante ligjore

11. Kushtetuta në nenin 14 (Shtetësia) përcakton: "*Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me lig.*"

12. Kushtetuta (Parimet e Përgjithshme) në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*” Paragrafi 2 i këtij neni thotë: “*Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*” Po ashtu, paragrafi 3 thotë: “*Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*”
13. Më tutje, Kushtetuta në nenin 50 (Të Drejtat e Fëmijës) përcakton: “*1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.*” Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: “*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*”
14. Kushtetuta në nenin 53 (Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut) përcakton: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*”
15. Kushtetuta në nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) përcakton: “*Te drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.*”⁴
16. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejshëm: KEMDNj), në neni 6, përcakton se e drejta për një proces të rregullt dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, është një ndër të drejtat e cila është sqaruar në shumë raste në praktikën e GjEDNj-së.
17. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF), në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*”
18. KDF-ja në neni 7 përcakton: “*1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre. 2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.*”

⁴ 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; 3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; 8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

19. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj),⁵ në nenin 15, mbi të drejtën e një shtetësie, si e drejtë për një individ për të pasur apo për t'i gëzuar të drejtat e tjera, ka përcaktuar: "1. Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie. 2. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë."
20. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)⁶ përcakton: "1. Çdo fëmijë, pa asnjë dallim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri apo lindje, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit, të cilët duhet të marrin masa për këtë qëllim. 2. Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe të ketë një emër. 3. Çdo fëmijë ka të drejtën e një shtetësie."
21. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEFDR)⁷ në nenin 5 kërkon nga shtetet që "ta ndalojnë dhe ta eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa asnjë dallim sa i përket racës, ngjyrës, ose origjinës nacionale apo etnike, për barazi para ligjit, veçanërisht në gëzim të së drejtës së shtetësisë".
22. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEFDG)⁸, në nenin 9, përcakton: "1. Shtetet palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë. Ato veçanërisht garantojnë që as martesë me një të huaj, e as ndërrimi i shtetësisë se burrit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bën atë pa shtetësi dhe nuk e detyron të marrë shtetësinë e burrit. 2. Shtetet palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit për sa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre."
23. Në Ligjin nr. 04/l-215 për Shtetësinë e Kosovës⁹: "përcaktohen mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullohen çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës."
24. Ligji nr. 04/l-003 për Gjendjen Civile¹⁰: "rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës."

Analiza ligjore dhe qëndrimi i Avokatit të Popullit

25. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.
26. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave, përfshirë edhe ato që parashohin regjistrimin e faktit të lindjes dhe fitimin e shtetësisë. Në këtë drejtim, Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të

⁵ <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

⁶ <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

⁷ <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CERD.aspx>

⁸ <http://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/cedaw.pdf>

⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8873>

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2743>

gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është domosdoshmëri i kohës dhe duhet respektuar nga të gjithë, përfshirë ndërmarrjen e masave procedurale për përshpejtimin e procedurës së marrjes së vendimit lidhur me çështjen.

27. Më tutje, Kushtetuta në nenin 14 (shtetësia) përcakton: *“Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me lig”*. Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës, në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës; Republika e Kosovës ua njeh të drejtën në shtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës më datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë. Regjistrimi i lindjes, fitimi i shtetësisë si dhe pajisja me dokumente personale nga gjendja civile (regjistrimi civil) është një e drejtë themelore, e cila është e rregulluar nga shumë instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, njëkohësisht kjo çështje është normuar edhe me akte juridike ligjore dhe nënligjore vendore. Regjistrimi civil është proces përmes të cilit personi identifikohet dhe njihet si pjesë integrale e shoqërisë ku ai/ajo jeton. Personat që nuk janë të regjistruar nuk kanë mundësi të pajisen me dokumente zyrtare dhe si rezultat i kësaj nuk kanë mundësi t'i ushtrojnë të plota të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut¹¹.
28. Më tutje, Kushtetuta përcakton së fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, nga keqtrajtimi dhe nga eksploatimi.¹² Gjithashtu, të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.¹³ Rrjedhimisht kanë ekzistuar obligimet shtetërore për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në këtë rast të të drejtave të fëmijës, për regjistrimin e mëvonshëm në regjistrat përkatës të gjendjes civile dhe fitimin e shtetësisë. Për më tepër, fryma apo konsiderata mbizotëruese, interesit më të mirë të fëmijës i jep edhe KDF-ja, e cila në tërë tekstin e saj ngërthen reflektimin në drejtim të mbrojtjes së tyre. Konventa sipas Kushtetutës është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Prandaj çdo veprim i organeve shtetërore duhet të jetë në pajtim të plotë me qëllimin e Konventës. Regjistrimi i lindjes është thelbësor pos tjerash edhe në përpjekjet e mbrojtjes, ku përfshihen: parandalimi i punës së fëmijëve duke përcaktuar moshën minimale për angazhim në punë; të siguruarit se fëmijët në konflikt me ligjin nuk trajtohen (juridikisht dhe në praktikë) si të rritur etj.
29. Bazuar në të drejtat dhe në liritë e njeriut, të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të drejtat e garantuara të dala nga instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, çdokush ka të drejtë, përveç tjerash: për identitetin personal, lirinë e lëvizjes, të drejtën për arsimin, mbrojtjen e pronës, të drejtën e martesës dhe të familjes, të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit, të drejtat e fëmijës, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtat

¹¹ <http://www.osce.org/sq/kosovo/92332>

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50, para. 1 dhe 3.

¹³ Po aty, para. 4.

civile dhe politike, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave etj., ushtrimi i të cilave varet direkt nga regjistrimi i gjendjes civile dhe i shtetësisë si dhe statusi i qëndrimit i rregulluar me ligj. Mungesa e përmbushjes së detyrimit shtetëror për regjistrimin e lindjes dhe të shtetësisë në regjistër të gjendjes civile dhe mospajisja me letërnjoftim i privon ata/ato drejtpërdrejt nga gëzimi i të drejtave elementare të njeriut të radhitura më lart.

30. Për shkak të statusit dhe pamundësisë për t'i ratifikuar konventat e Kombeve të Bashkuara, autoritetet e Kosovës e kanë identifikuar mënyrën më të përshtatshme për të përfshirë traktate të ndryshme përmes Kushtetutës duke siguruar zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë mbi legjislacionin e Kosovës. Në këtë drejtim, aplikimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është paraparë për çështjet që prekin shtetësinë.¹⁴
31. KDF-ja¹⁵ ka përcaktuar se fëmija regjistrohet menjëherë sapo të lindet dhe qysh nga atëherë e ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për t'i njohur prindërit e tij dhe për ta pasur kujdesin e tyre. Frymën e sigurimit dhe jetësimit të këtyre të drejtave, KDF-ja e ka përcaktuar në nenin 7, paragrafi 2: *"Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetet pa shtetësi."* Tutje KDF-ja, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në vend,¹⁶ në nenin 3, përcakton: "1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese." Rrjedhimisht autoritetet shtetërore duhet t'i kenë para se gjithash këto standarde ndërkombëtare në mbrojtjen e interesit të fëmijëve, përkatësisht që të sigurojnë regjistrimin e fëmijës në regjistrat përkatës të gjendjes civile. KDF-ja thekson se secili fëmijë "duhet të regjistrohet menjëherë pasi të lindet dhe qysh nga kjo kohë duhet të ketë të drejtë për emër, të drejtë të fitojë nënshtetësi dhe, aq sa është e mundur, të drejtë të njihet dhe të kujdeset prej prindërve." Po ashtu, KDF-ja thekson se "akterët shtetërorë duhet të sigurojnë jetësimin e këtyre të drejtave në harmoni me ligjin kombëtar të tyre dhe obligimet e tyre nën instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, në veçanti kur fëmija në të kundërtën do të mbetet pa nënshtetësi." Dështimi në njohjen nga shteti do të thotë për fëmijën mohim i qasjes në shërbimet elementare, siç janë: shërbimet shëndetësore e arsimimi dhe përjashtim nga çfarëdo mbrojtje juridike, e cila garanton realizimin e të drejtave thelbësore njerëzore.
32. Gjithkush ka të drejtën e një shtetësie të garantuar me DUDNJ¹⁷, si e drejtë për një individ për të pasur apo për t'i gëzuar të drejtat e tjera. Avokati i Popullit vëren se mosregjistrimi civil dhe fitimi i shtetësisë për individët, përkatësisht fëmijët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, pos tjerash, është një pengesë për qasje në arsim, në punësim, në mbrojtje sociale, në shërbime shëndetësore dhe në banim. Tutje

¹⁴ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEFDR); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

¹⁵ <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

¹⁷ <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

PNDKP-ja¹⁸ përcakton: “1. Çdo fëmijë, pa asnjë dallim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri apo lindje, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit, të cilët duhet të marrin masa për këtë qëllim. 2. Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe të ketë një emër. 3. Çdo fëmijë ka të drejtën e një shtetësie.” Rrjedhimisht këto dispozita përcaktojnë rëndësinë e regjistrimit të lindjes së fëmijëve, si dhe fitimin e shtetësisë si një prej të drejtave themelore të njeriut.

33. KEFDR-ja¹⁹ në nenin 5 kërkon nga shtetet: “Ta ndalojnë dhe ta eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa asnjë dallim sa i përket racës, ngjyrës, ose origjinës nacionale apo etnike, për barazi para ligjit, veçanërisht në gëzim të së drejtës së shtetësisë.” Sipas Raportit për Kosovën 2019, Kosova ka korniza adekuate institucionale dhe ligjore për të drejtat dhe mbrojtjen e **pakicave**, duke përfshirë strategjitë dhe planet relevante të veprimit, por implementimi mbetet i dobët. Ato vazhdojnë të përballen me sfida sa i përket mjedisit të sigurt, rimarrjes dhe qasjes në prona, **regjistrimit civil**, mundësinë për përdorim të gjuhës së tyre, lehtësirave të duhura për arsim, mundësi për punësim dhe mirëqenie sociale.
34. Konventat kryesore ndërkombëtare, të cilat adresojnë mungesës e shtetësisë, janë Konventa për Reduktimin e Pashtetësisë²⁰ e vitit 1961 në lidhje me të drejtën e shtetësisë për fëmijët si dhe Konventa në lidhje me Statusin e Personave Pashtetësi²¹ e vitit 1954. Të dy konventat sigurojnë që njerëzit pa shtetësi ose në rrezik të pashtetësisë gëzojnë të drejta minimale të njeriut, si: e drejta mbi arsimim, punësim, strehim dhe mundësinë e përdorimit të mjeteve juridike, si dhe detyron shtetet të krijojnë masa mbrojtëse në legjislacion për të adresuar pashtetësinë e cila ndodh gjatë lindjes ose më vonë në jetë. Konventa Evropiane për Shtetësinë (KESH)²², në nenin 6 (2) thekson: “Çdo shtet palë duhet të parashikojë në ligjin e vet nacional fitimin e shtetësisë për fëmijët e lindur në territorin e tij të cilët me lindje nuk fitojnë një shtetësi tjetër.”, dhe Konventa mbi Shmangien e Pashtetësisë në raport me Vazhdimësinë e Shteteve²³, miratuar nga Këshilli i Evropës më 2006, përmban dispozitat më të hollësishme nga çdo traktat ndërkombëtar për detyrimet e shtetit për ta parandaluar dhe për ta reduktuar pashtetësinë në përputhje me kontekstin e suksedimit të shtetit. Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ka dispozita të ndryshme që mund të shërbejnë si bazë ligjore për legjislacionin e Bashkimit Evropian për identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi. Me një fjalë, artikuj të caktuar të traktatit kanë një rëndësi të konsiderueshme, pasi ato ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për të shërbyer si bazë për legjislacionin e BE-së për identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi. Rrjedhimisht, standardet ndërkombëtare të lartcekura për të drejtat e njeriut e mbrojnë të drejtën e çdo individi, veçmas të drejtat e fëmijës për t’u njohur si person para ligjit, për t’u regjistruar menjëherë pas lindjes, për të pasur emër dhe për të fituar shtetësi.
35. Aktualisht, korniza ligjore që e rregullon fushën e regjistrimit civil, të shtetësisë dhe të dokumenteve të identifikimit, të përshkruara si në vijim: Ligji nr. 04/1-215 për Shtetësinë

¹⁸ <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

¹⁹ <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CERD.aspx>

²⁰ <https://www.refworld.org/docid/3ae6b39620.html>

²¹ <https://www.refworld.org/docid/3ae6b3840.html>

²² <http://www.unhcr.org/protection/statelessness/451790842/european-convention-nationality.html>

²³ <https://rm.coe.int/1680083747>

- e Kosovës²⁴, Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile²⁵, Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës²⁶, Ligji nr.05/L-015 për Letërnjoftim²⁷ si dhe Ligji nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin²⁸, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, implementimi në praktikë mbetet sfidues për shkak të interpretimit të pa unifikuar në zbatim të dispozitave ligjore.
36. Avokati i Popullit vëren se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Gjykata Evropiane).
37. GjEDNj-ja, në rastin Kurić dhe të Tjerë kundër Sllovenisë²⁹, gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e “jetës private ose familjare”, ose të të djave (neni 8 i Konventës), të drejtën për zgjidhje efektive (neni 13) dhe ndalimin e diskriminimit (neni 14, i lexuar bashkë me nenin 8) në lidhje me fshirjen nga regjistri i banorëve të përhershëm nga autoritetet sllovene, me ç’ rast rezultoi me humbjen e statusit ligjor të kërkuesve: z. Kurić, znj. Mezga, z. Ristanović, z. Berisha, z. Ademi dhe z. Minić. Për pasojë, jo vetëm kërkuesit në këtë çështje, por gjithashtu edhe një numër i madh personash të tjerë ishin prekur dhe vazhdonin të prekeshin nga ajo masë. GjEDNj-ja gjeti se shkelja në thelb kishte filluar me dështimin e zgjatur të autoriteteve sllovene që ta rregullonin statusin e qëndrimit të kërkuesve pas “fshirjes” së tyre të paligjshme nga regjistri i banorëve të përhershëm dhe për t’u ofruar atyre një zgjidhje të përshtatshme. Gjykata gjithashtu tha se kërkuesit mund të pretendojnë se janë “viktima”, sipas nenit 34 të Konventës, për shkeljet e përmendura të të drejtave të tyre që rrjedhin nga Konventa.
38. GjEDNj-ja ka vendosur që neni 8 i KEDNj-së përmban garanci procedurale për ta parandaluar ndërhyrjen arbitrare në të drejtën e jetës private dhe familjare. Kjo pikë ndikon dhe ndihmon personat të cilët, pavarësisht se kanë hyrë vetëm në një shtet, kanë krijuar një jetë private dhe familjare. Parregullsitë në aspektet procedurale të procesit të vendimmarrjes sipas nenit 8 mund të rezultojnë si shkelje të paragrafit 2 të këtij neni.
39. Njohja si person para ligjit është e drejtë themelore e njeriut³⁰. Regjistrimi civil është proces përmes të cilit një person identifikohet dhe njihet si pjesë integrale e shoqërisë në të cilën jeton³¹. Personat që nuk janë të regjistruar, nuk janë në gjendje që të marrin dokumente zyrtare, prandaj edhe ndalohen në ushtrimin e të drejtave dhe të lirive të tyre. Mirëpo, derisa në realitet asnjë individ nuk ndalohet që të ketë qasje në regjistrim civil, ende ka barriera për regjistrim që kryesisht i prekin grupet më të cënueshme në Kosovë. Një pjesë e madhe e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës mbesin të paregjistruar në regjistrat civil të Kosovës dhe nuk kanë dokumente personale të identifikimit³², pa të cilat iu mohohen të drejtat e tyre themelore në fusha të ndryshme, përfshirë mbrojtjen dhe mirëqenien sociale, punësimin, arsimin dhe shëndetësinë. Është

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8873>

²⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2743>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

²⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11278>

²⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2589>

²⁹ <https://www.refworld.org/cases,ECHR,4fe9c88c2.html>

³⁰ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 6.

³¹ OSBE, 2012, Kontribut për shqyrtimin e progresit të planit të veprimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2009–2015.

³² Po aty fq. 29.

arritur deri diku përparim në sigurimin e regjistrimit civil të atyre që janë më të cenueshmit, në veçanti komunitetet rom, ashkali dhe egiptian të Kosovës. Mirëpo mbetet shumë për t'u bërë në këtë fushë.

40. Bazuar në Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të miratuar nga Kombet e Bashkuara, më 25 shtator 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka nxjerrë rezolutë³³ me të cilën janë miratuar Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose Agjenda 2030) bazuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A/RES/70/1, e miratuar nga 193 liderë nga mbarë bota, më 25 shtator 2015, dhe të lidhura me Deklaratën e Konferencës Botërore të Kryetarëve të Paramenteve si pikat kryesore të referencës mbi të gjitha politikat për zhvillim të qëndrueshëm.
41. Agjenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm,³⁴ që përfshinë Objektivat e Qëndrueshëm Zhvillimore, që janë pikë udhëheqëse e re e agjendës zhvillimore globale, përfshin, pos tjerash, edhe çështjen që të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë.
42. Duke u mbështetur në konsensusin universal, Agjenda 2030 e Objektivate për Zhvillim të Qëndrueshëm,³⁵ në kuadër të Qëllimit 16,³⁶ Objektivi 9, shprehimisht përcakton: “*Deri në vitin 2030, të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë duke përfshirë regjistrimin e faktit të lindjes.*” Sipas këtij konsensusi, statistikat vitale janë një komponent thelbësor për monitorimin e zbatimit të Agjendës 2030 dhe vlerësimin e progresit në zbatimin e objektivate për zhvillim të qëndrueshëm. Sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara, dhënë në këtë nismë globale, sistemi i statistikave të rregullta, të besueshme dhe të sakta varet nga regjistrimi i plotë civil dhe raportimi i ndodhjes së të gjitha ngjarjeve vitale. Roli i regjistrimit civil shkon përtej burimit të statistikave vitale, pasi është thelbësor për të siguruar identitetin ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Konkluzion

- Avokati i Popullit, pas rishikimit të legjislacionit përkatës, instrumenteve ndërkombëtare, dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të dhënave që i ka, konsideron se në rastin konkret, mossa i identitetit ligjor të personave në fjalë përmban *shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve.
- Si rezultat kemi 23 individë pa identitet ligjor, të cilët nuk mund të kenë qasje në të drejtat themelore të njeriut. Individë të moshave të ndryshme që janë duke pritur zgjidhje në nivelin gjyqësor. Koha mesatare e pritjes për zgjidhje në cilindo prej niveleve, në përputhje me sfidat e lartpërmendura, ka zgjatur disa vite.

³³ http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_01_30_Rezoluta_06_R_001.pdf

³⁴ United Nations General Assembly, Transforming Our World: The 2030 Agenda for sustainable Development (2015), A/RES/70/1

³⁵ Në shtator të vitit 2015, liderët botërorë miratuan Agjendën e 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo agjendë përfshinë 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe 169 nënobjektiva që duhet të arrihen deri në vitin 2030. Kjo është një thirrje universale për veprim, për t'i dhënë fund varfërisë, për ta mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ajo është bashkuar me përpjekjet globale për t'i dhënë fund të gjitha formave të varfërisë, për ta luftuar pabarazitë dhe për ta trajtuar çështjet mjedisore me partnerët rajonalë. Lista e Qëllimeve dhe e Objektivate për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Agjenda 2030: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/11803Official-List-of-Proposed-SDG-Indicators.pdf>

³⁶ Objektivi 16 përcakton: “Të nxiten shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurohet qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtohen institucione efektive, përgjegjëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.”

- Avokati i Popullit, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe me legjislacionin relevant në fuqi, nuk ka kompetenca ndaj vendimeve të gjykatave kompetente të cilat ndërlidhen me rastet në fjalë.
- Gjithsesi, në frymën e interesit më të mirë të fëmijëve dhe të personave të tjerë të rritur lidhur me çështjen, Institucioni i Avokatit të Popullit rikujton se parimi i shtetit të së drejtës obligon autoritetet publike, përfshirë gjykatat, që t'i kushtojnë rëndësi dhe kujdes të veçantë zbatimit praktik të instrumenteve ndërkombëtare dhe të akteve vendore të kësaj fushë.
- Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se traktatet dhe aktet ligjore vendore të lartpërmendura përcaktojnë standardet dhe masat mbrojtëse të rëndësishme për të siguruar që lindja e fëmijëve do të regjistrohet, si dhe shtetësia do t'u jepet.
- Për këtë arsye, Avokati i Popullit, në pajtim me Kushtetutën dhe me instrumentet ndërkombëtare, si dhe me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, vlerëson domosdoshmërinë për ndërmarrjen e masave procedurale dhe materiale që të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë qytetarët e vendit.
- Avokati i Popullit, bazuar në analizën ligjore dhe në konstatimet e lartcekura, inkurajon gjykatën që rastet e tilla të trajtohen me prioritet, në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë unike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pos tjerash, në harmoni me praktikat dhe me standardet ndërkombëtare.


 Me nderime,
 Hilmi Jashari
 Avokat i Popullit